

Kërkesat e studentëve drejtuar Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë

Studentët kërkojnë mirëkuptim për të gjithë kërkesat e listuara. Këto janë kërkesat e çdo studenti të institucioneve publike të larta arsimore dhe kërkohet të zbatohen në secilin prej tyre. Premtojmë se, në rast të mosplotësimit të tyre, do jemi të gatshëm të rikthehemi me protesta që në momentin e parë. Për rrjedhojë, fillimi i sezonit të radhës të provimeve, dhe semestrit të radhës mësimorë do të jenë logjikshëm dy momentet ku presim rezultate për kërkesat e listuara mëposhtë. Në rast mosplotësimi, do bojkotojmë kryerjen e pagesave për tarifat shkollore, sezonin e provimeve, ashtu si dhe vazhdimin e semestrit të radhës mësimorë. Do të rikthehemi në protestë. Çdo dhjetor do të jemi në protestë për të kërkuar plotësimin e kërkesave të studentëve.

1. Të rivlerësohet çmimi për tarifat arsimore. Tarifat të ulen në nivel të përballueshëm. Diferencat të mbulohen nga buxheti i shtetit. **Kjo kërkesë të plotësohet brenda këtij viti akademik.**
2. Pagesa e tarifës për shkollim të bëhet jo vetëm e plotë, por edhe e ndarë në 2 - 4 këste, pavarësisht shumës totale. Pagesat të kryhen në fund të çdo semestri mësimorë (janar dhe qershor), pasi të jetë siguruar mbarëvajtja normale e tij dhe plotësuar pritshmëritë e studentëve. Studenti përsëritës i vitit akademik nuk duhet të paguajë të plotë vlerën e vitit akademik. Pagesa duhet të varet nga kreditet e lëndeve në të cilët është mbetës. Vlera e kreditit për këtë pagesë duhet të jetë sa gjysma e vlerës së plotë të një krediti. (Arsyeja? Ashtu siç mban përgjegjësinë dhe pasojat studenti për dështimin e tij, duhet të mbajë përgjegjësi dhe pasoja edhe institucioni akademik që dështoi në përmbushjen e objektivave me studentin në fjalë.) **Kjo kërkesë të vihet në zbatim menjëherë.**
3. Pasqyra financiare e veprimtarisë ekonomike e institucionit publik të arsimit të lartë e përpiluar në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar, të publikohet çdo vit prej tij. Prej institucionit publik të arsimit të lartë, në sektor të veçantë të faqes web të aksesueshme nga të gjithë, të bëhet publikimi i plotë i pasqyrës financiare të veprimtarisë ekonomike. **Kjo kërkesë të vihet në zbatim menjëherë.**
4. Institucioni publik i arsimit të lartë nuk duhet të kërkojë pagesa shtesë për lëshimin e vërtetimeve apo listave të notave. **Kjo kërkesë të vihet në zbatim menjëherë.**
5. Ministria përgjegjëse për arsimin duhet të monitorojë dhe kërkojë plotësimin e kushteve funksionale në mjedisin e çdo institucioni publik të arsimit të lartë. Secili institucion duhet të gëzojë infrastrukturë bashkëkohore laboratorike të përshtatshme me qëllimet studimore të tij. Duhet të krijohet një sistem (ndoshta elektronik, ndoshta nëpërmjet referimit nga zyra e ankesave) që monitoron zhvillimin e mësimi si dhe penalizon çdo pedagog që paraqitet me vonesë, nuk kryen seancat e plota, apo nuk paraqitet fare për kryerjen e seancës mësimore. Duhet të krijohen biblioteka në raport të drejtë me numrin e studentëve që ka institucioni. Bibliotekat të jenë të aksesueshme 24-orë. Institucioni duhet të mundësojë hyrje falas në internet në të gjithë hapësirën e tij territoriale. **Kjo kërkesë të plotësohet brenda këtij viti akademik.**
6. Ministria përgjegjëse për arsimin duhet të monitorojë dhe mundësojë plotësimin e kushteve në konviktet e studentëve. Plani për investim duhet të përshpejtojë. **Kjo kërkesë të plotësohet brenda këtij viti akademik.**
7. Ministria përgjegjëse për arsimin duhet të krijojë një mekanizëm kombëtarë që prodhon dhe shpërndan Kartën e Studentit, të njëvlefshme në të gjithë territorin e vendit. Nëpërmjet saj studenti të gëzojë përfitime lehtësuese, si për shembull transportim falas në mjetet e qarkullimit publik, ulje në shërbimet e rëndësishme jetike si ujë, energji elektrike, etj. **Kjo kërkesë të plotësohet brenda këtij viti akademik.**

8. Të kryhet vlerësimi i integritetit dhe aftësisë të pedagogëve. **Kjo kërkesë të plotësohet brenda këtij viti akademik.**
9. Për të mos i dhënë më mundësinë një pedagogu pa integritet, të paaftë apo të padenjë për të qenë pjesë e auditorit, përveç filtrave që mund të bëhen në mënyra të tjera, çdo studenti ti jepet e drejta për të vendosur vetë se kush do të jetë pedagogu me të cilin dëshiron të zhvillojë çdo lëndë mësimore. Institucioni publik i arsimit të lartë të detyrohet të paraqesë në fillimin e çdo semestri mësimorë të paktën 2 alternativa pedagogësh kandidatë për zhvillimin e çdo lënde mësimore. **Kjo kërkesë të implementohet që në semestrin e radhës (semestri 2) mësimorë, të vitit akademik aktual.**
10. Institucioni publik i arsimit të lartë duhet të garantojë transparencë maksimale në vlerësimin e çdo provimi. Çdo provim, të shoqërohet me zgjidhje të zhvilluara nga titullarët e lëndës, të publikuara menjëherë mbas mbajtjes së provimit. **Kjo kërkesë të implementohet që në sezonin e radhës (dimëror) të provimeve, të vitit akademik aktual.**
11. Ministria përgjegjëse për arsimin të ngrejë grup pune për hartimin e një plani kombëtarë me qëllim krijimin e kurrikulave bashkëkohore mësimore për çdo lëndë që zhvillohet në secilin nga institucionet publik të arsimit të lartë. Të krijohet "Shtëpia botuese e teksteve universitare", si institucion buxhetor në varësi të saj. Ky institucion të mundësojë botimin, shpërndarjen dhe shitjen e tekstit universitar me çmim të reduktuar për studentët e targetit përkatës pranë institucioneve publik të arsimit të lartë. Botimet të mirëpunohen me të njëjtin standard si shembujt ekuivalent në botën akademike perëndimore. Të punohet për krijimin e një biblioteke virtuale të përbashkët për të gjithë institucionet e arsimit të lartë (privat dhe publik), ku çdo student të ketë të drejtë të shfletojë (pa asnjë pagesë) versionin elektronik të secilit botim. **Struktura të jetë funksionale në vitin e radhës akademik.**
12. Në çdo institucion publik të arsimit të lartë Ministria përgjegjëse për arsimin të përfaqësohet me një zyrë informacioni dhe ankesash, të pavarur nga institucioni. Kjo zyrë të presë dhe adresojë ankesat e studentëve dhe pedagogëve. Zyra të funksionojë me kohë të plotë. Të gjithë shpenzimet për shërbimin e kësaj zyre të mbulohen me fond të veçantë nga kjo ministri. **Kjo kërkesë të plotësohet brenda këtij viti akademik.**
13. Personat fizik/juridik/organizatat që zhvillojnë veprimtari ekonomike, që kryejnë donacione të vlerësuara të konsiderueshme në institucionet publike të arsimit të lartë të përfitojnë lehtësira tatimore brenda vitit tatimor kur japin këtë kontribut. **Kjo kërkesë të vihet në zbatim menjëherë.**
14. Të garantohet zhvillimi i praktikave mësimore. **Kjo kërkesë të vihet në zbatim menjëherë.**
15. Të përcaktohet detyrim ligjor për punësim të të paktën një të sapodiplomuari çdo vit nga çdo sipërmarrje jo e vogël. **Kjo kërkesë të plotësohet brenda këtij viti akademik.**